



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	22/05/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Xhemajl BUZUKU Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
CC:	z. Xhavit DAKAJ Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë"



I nderuar z. BUZUKU,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë" me nr. të prokurimit: 208-14-057-511 Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT ka përgatitur “ Njoftimin për Kontratë ” me titull “Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë “ me nr. Prokurimi 208-14-057-511, e cila është publikuar në KRPP më datë: 29/04/2014, me Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit të kësaj procedure të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me Procedurat e Prokurimit sipas Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në Dosjen e Tenderit, rubrika Kërkesat mbi Gjendjen Ekonomike dhe Financiare 8.1, pika III.2.2 Përshtatshmëria Profesionale, kërkohet: a) Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik-Certifikata Regjistrimit të Biznesit; b) Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (për Kompanitë Kosovare); dhe c) Certifikata me Numër Fiskal (për Kompanitë Kosovare), ndërsa tek Dëshmia e kërkuar dokumentare janë kërkuar dëshmi për 4 pozicione (a, b, c, d) deri sa tek kërkesat ishin tre pozicione (a, b, c). Bëhet fjalë për Certifikatën ISO 9001:2008 e cila nuk është kërkuar si kërkesë, ndërsa kërkohet dëshmi për ta dokumentuar.

Në Dosjen e Tenderit, Pika III.2.3 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar kërkohet: Vlera e përgjithshme monetare e punëve të ekzekutuara në lëmin e ndërtimit, në tri vitet e fundit, për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës; Përveç qarkullimit minimal, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë edhe referenca në fushën specifike, por shumica e tyre nuk mund të kalojë më shumë se 1.5 herë vlerën e parashikuar. Në të njëjtën pikë poashtu kërkohet: Raporti i Auditimit për tri vitet e fundit 2010, 2011 dhe 2012 . Në rast Konzorciumi secili nga anëtarët e Konzorciumit duhet ta kenë raportin e Auditimit për (2010,2011 dhe 2012) nga auditorët e certifikuar. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar raport Auditimi për tre vitet e fundit ndërsa nuk ka përfshirë vitin 2013, pra tre vitet e fundit janë 2011, 2012 dhe 2013, e jo siç ka paraparë Autoriteti Kontraktues vitin 2010, 2011, 2012. Konsiderojmë se një formulim i tillë mund të shkaktojë huti tek Operatorët Ekonomik si dhe tek Komisioni Vlerësues gjatë vlerësimit të tenderit. Autoriteti Kontraktues po ashtu ka kërkuar raportin e Auditimit për nga auditorët e certifikuar. Udhëzimi Administrative e ka paraparë qartë se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporte të menaxhmentit të certifikuara nga një kompani e licencuar a auditivitet me reputacion, por jo edhe nga Auditor të Licencuar që nuk janë kompani.

Në Dosjen e Tenderit, tek Kërkesat minimale mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale, kërkohet: Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale e personelit, së paku tre inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ekzekutimin e projektit të punëve ose për realizimin e aktivitetëve të ndërtimit te deklaruar dhe te vërtetuar nga ATK për tre muajt e fundit Menaxheri i projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë, me përvojë 8 vjeçare. Autoriteti Kontraktues edhe në pikat e mëposhtme ka kërkuar përvojë fikse (me përvojë pune 5 vjet). Minimum një (1) Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi Konstruktiv – me përvojë pune 5 vjet; Minimum një (1) Inxhinier i



Diplomuar i Ndërtimtarisë – Hidroteknikës - me përvojë pune 5 vjet; Minimum një (1) Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës- me përvojë pune 5 vjet; Minimum një (1) Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë – me përvojë pune 5 vjet. Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet se ka paraqitur si kritere, kërkesat minimale, e jo si në rastin konkret përvojën fikse e cila është dhe diskriminuese.

Në Dosjen e Tenderit, pika 13.2 thuhet se: Shuma e Sigurimit të Tenderit duhet të jetë në vlerë: 75.000,00€. Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet se shuma e kërkuar për sigurimin e tenderit do të jetë 3-5% e shprehur në vlerë monetare e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në Dosjen e Tenderit, Pika 23.1 Afati i fundit i dorëzimit të tenderit, thuhet: Afati i fundit për dorëzim është: 23.05.2014 ; ora 10.00; si dhe Pika 26.1 Hapja e Tenderit, thuhet: Hapja e tenderit do të bëhet me: 23.05.2014 ; ora 10.30. Afati i dorëzimit si dhe koha e hapjes së ofertave mund të jetë deri në orën 16:00. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ajo është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit. Në rastin konkret Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që tenderët të dorëzohen në ora 10:00, ndërsa hapja e ofertave të operatorëve ekonomik të bëhet në ora 10:30.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 5 Kalkulimi i afateve kohore, nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi si dhe nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, Gjendja Ekonomike dhe Financiare i UA-02/2014, pika 23 Kriteret e Përzgjedhjes dhe pika 26 Sigurimi i Tenderit nga Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe shmangien e praktikave të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

